



E ardhmja nis me ne!



“HORIZON SCHOOL”

Njësia Lipjan



RREGULLORE E RENDIT SHTËPIAK

SHTATOR, 2023

Bazuar në Nenin 22 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ 06/2014 nga MASHTI, Këshilli Drejtues i Institucionit Privat të Arsimit Parauniversitar “Horizon School”, miratoi këtë rregullore për Njësinë në Lipjan:

RENDI SHTËPIAK

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësiive për nxënësit, prindërit dhe vetë shkollën.

Neni 1

Të drejtat e nxënësve

1. Të trajtohen me respekt dhe mirësi. Kjo do të thotë se askush nuk do të përqeshë apo lëndoj ndjenjat e tyre;
2. Të jenë personalitet në klasë. Kjo do të thotë se askush nuk do ti trajtojë në mënyrë të padrejtë vetëm se janë: vajzë apo djalë, i plotë apo i dobët, i shpejtë apo i ngadalshëm;
3. Të jenë të sigurtë në klasë. Kjo do të thotë se askush nuk do ti godas, shtyjë, ngacmoj, fyej apo lëndoj në asnjë mënyrë;
4. Të mësojnë për vetveten në klasë. Kjo do të thotë se do të jenë të lirë të shprehin ndjenjat dhe mendimet pa frikë;
5. Të caktojnë objektiva dhe ti arrijë ato në bashkëpunim me akterët tjerë në shkollë;
6. Të çmohen dhe respektohen së bashku me vlerat dhe dobësitë e tyre.

Neni 2

Përgjegjësitë e nxënësve

1. Secili nxënës është i detyruar të vijojë me rregull procesin mësimor.
2. Secili nxënës ka për detyrë që të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët.
3. Secili nxënës ka për detyrë që t’i respektojë të tjerët. Kjo do të thotë se në shkollën tonë nuk do të lejohet që ndaj ndonjërit të përdoret dhuna dhe agresiviteti fizik, duke përfshirë edhe lojërat “luftarake”.
4. Të jenë të saktë dhe t’i kryejnë obligimet në kohë.
5. Të jenë tolerant dhe ti pranojnë ndryshimet në shoqëri.
6. Për sjellje jo të mira çdoherë duhet të jepet përgjegjësi. Në raste të tilla vjen deri te biseda me prindin/kujdestarin, mësimdhënësit, raportimi dhe masat.
7. Në raste më serioze, nxënësi mund të largohet nga shkolla për një kohë të caktuar e pastaj të kthehet së bashku me prindin/kujdestarin që të shqyrtohen hapat e ardhshëm. Në rast se nuk ka përmirësime, nxënësi largohet përgjithmonë nga shkolla.

8. Shkolla jonë synon t'i përkrahë nxënësit me sjellje të mira, me vetë-disiplinë dhe nxënësit me vullnet për mësim. Kur nxënësi sillet mirë dhe tregon rezultate kjo do të vlerësohet nga mësimdhënësit. Nëse nxënësi tregon rezultate të mira në mësim apo aktivitete tjera, ai/ajo do të shpërblehet.
9. Nëse ndihen të ofenduar për shkak të asaj që ju kanë thënë apo bërë të tjerët, keni të drejtë dhe jeni të shtyrë të raportoni.
10. Në shkollë nxënësi lejohet të sjellë vetëm gjëra të nevojshme për procesin mësimor, rreptësishtë ndalohen armët e ftohta dhe armë tjera, mjete të mprehta, duhan, mjete ndezëse dhe plasëse, droga dhe alkoole, si dhe çdo mjet ose lëndë tjetër të rrezikshme dhe të pa përshtatshme.
11. Të respektohet shkolla, ambientet, mjetet shkollore, pajisjet, stafi administrativ, mësimdhënësit dhe drejtorja e shkollës.
12. Nxënësi është përgjegjës për çdo gjë që e sjellë në shkollë, nëse humbet apo vidhet.
13. Rreptësishtë ndalohet të sillen në shkollë mjete të forta apo çfarëdo tjetër që do të mund të lëndojë këdo.
14. Të respektojnë orarin e udhëtimit dhe të tregojnë sjellje të rregullt në mjetet e transportit.

Neni 3

Përgjegjësitë e prindërve

1. Të përkrah nxënësin të jetë i suksesshëm në shkollë, prindi të jetë aktiv.
2. Të kujdeset për uniformën dhe pajisjet e nevojshme shkollore.
3. Të kujdeset që do të vijë i përgatitur fizikisht, që të mos ketë problem në përqendrim.
4. Të obliguar të njoftojnë shkollën për gjendjen shëndetësore të fëmijëve të tyre dhe të mos fshehin asnjë të dhënë lidhur me shëndetin psiko-fizik të fëmijëve të tyre.
5. Të njoftoj për mungesën e nxënësit në rast të ndonjë sëmundje apo arsyeje tjetër, më së largu deri në ora 08:30 të ditës përkatëse.
6. Nëse nxënësi duhet të lirohet apo të mungoj gjatë një kohe të caktuar për ndonjë arsye objektive, shkolla duhet të njoftohet paraprakisht dhe të sillet dokumentacion mbështetës.
7. Të sigurohet që janë kryer pagesat e nevojshme për nxënësin.
8. Të jenë aktiv dhe të interesuar për edukimin e nxënësit në bashkëpunim me shkollën.
9. T'i lexoj raportet dhe letrat e dërguara nga shkolla, si dhe të bëj të pamundurën që njëri nga prindërit/kujdestarët e nxënësit do të jenë prezent në takimet e ftuara nga shkolla apo mësimdhënësi.
10. Nëse në shtëpinë e nxënësit ndodh diçka që do të ndikojë në mbarëvajtjen e mësimin të nxënësit, duhet të njoftohet shkolla.
11. Do të respektoj shkollën dhe gjithë personelin edukativ.
12. Do të respektoj çdo masë disiplinore që merret ndaj nxënësit.

Neni 4

Përgjegjësia e mësimdhënësve

1. Të jenë të përgatitur për çdo orë mësimore.
2. Të realizojnë planet dhe arrijnë rezultatet e secilës fushë/lëndë mësimore.
3. Të tregojnë përkushtim maksimal për secilin nxënës.
4. Të kujdesen për literaturën dhe materialet nevojshme pedagogjike.
5. Të respektojnë të drejtat e nxënësit, kolegut dhe shkollës.
6. Të plotësojnë të gjitha dokumentet pedagogjike sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.
7. Të respektojnë privatësinë e nxënësve.
8. Të respektojnë etikën dhe kodin e veshjes së mësimdhënësit.
9. Të respektojnë orarin dhe secilën orë mësimore.

Neni 5

Përgjegjësitë e shkollës

1. Të sigurojë shkollim cilësor.
2. Të sigurojë ambient të sigurtë dhe të shëndetshëm.
3. Të punoj sipas rregullave dhe programeve të përcaktuara nga MASHTI.
4. Të respektoj të drejtat e secilit nxënës.
5. Të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë nxënësit.
6. Të sigurojë mjedisin e brendshëm sipas legjislativit në fuqi.
7. Të siguroj përshtatshmërinë sanitare.
8. Të sigurojë ambientin e jashtëm sipas legjislativit në fuqi.
9. Të respektoj kërkesat shëndetësore për nxënësit.
10. Të kujdeset për ushqimin e nxënësve në shkollë.
11. Të mbledhë telefonat dhe pajisjet tjera komunikuese të nxënësve para fillimit të procesit mësimor dhe ti kthej ato te nxënësit pas përfundimit të procesit mësimor.

Neni 6

Qëndrimi i nxënësve në shkollë

1. Pranimi i nxënësve në shkollë bëhet nga ora 08:00 deri në orën 08:20. Ora e I-rë mësimore fillon në ora 08:30.
2. Ora e fundit mësimore përfundon në ora 15:35. Nxënësit nga ora 15:40 fillojnë transportin për në shtëpitë e tyre.
3. Në rast të nevojës për largimin e nxënësit nga shkolla gjatë orarit mësimor, prindërit ose një person i autorizuar duhet të vijnë në shkollë për të marrë nxënësin.
4. Përveç rasteve sikur në pikën më lartë, Neni 5, pika 3, nxënësit nuk mund të dalin nga ambientet e jashtme të shkollës gjatë orarit mësimor.

Neni 7

Sjellja e gjërave të çmuara dhe lodrave nga nxënësit

1. Ndalohet sjellja e gjerave të çmuara nga nxënësit në shkollë, për shkak të mundësisë së dëmtimit, humbjes, lëndimit dhe kompleksitetit të çështjes.
2. Ndalohet sjellja e lodrave personale në shkollë, për të shmangur lëndimin dhe mosmarrëveshjet mes nxënësve, nxënësit do të shfrytëzojnë lodrat e shkollës.

Neni 8

Disiplina e nxënësve në shkollë dhe aktivitete jashtë shkollës

1. Nxënësit janë të obliguar të respektojnë rendin në shkollë dhe në aktivitete jashtë shkollës.
2. Të mos pengojë shokun ose shoqen gjatë qëndrimit në shkollë ose jashtë qendrës, duke i ndërhyrë verbalisht, dhunë psikologjike ose duke e ngacmuar fizikisht.
3. Të mos e dëmtojë inventarin dhe ambientet e shkollës dhe ta mirëmbajë atë.
4. Të mos i dëmtoj pemët, rrethojës, ulëset, lodrat, shportave higjienike dhe të tjera në oborrin dhe kopshtin e shkollës, si dhe në vizitat jashtë qendrës;
5. Të respektohet rregulli gjatë kohës së ushqimit, të rregullohet tavolina dhe të largohen mbeturinat.
6. Nxënësit nuk guxojnë të vrapojnë dhe të shtyhen mes vete në ambientet e shkollës.

Neni 9

Dispozita përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Për mos respektimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë rregullore të rendit shtëpiak, si dhe sjellje apo veprime të tjera, ndërmerren masa disiplinore të përcaktuara nga Ligji për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimi Administrativ përkatës, si dhe Kodi i Mirësjelljes dhe Rregullorja për organizmin e punës së Horizon School.
2. Kjo Rregullore e rendit shtëpiak hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetar i Këshillit Drejtues

Prof.Dr.Besim Beqaj